



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE**

**V E N D I M**

**Nr. 321, datë 15. 05. 2019**

**PËR  
FINANCIMIN E PROJEKTIT “DIASPORA SHKENCORE SI NJË  
FAKTOR NDRYSHIMI NË PROCESIN E INTEGRIMIT  
EVROPIAN TË SHQIPËRISË” DHE ZBATIMIN E TIJ NGA FONDI  
SHQIPTAR PËR ZHVILLIMIN E DIASPORËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45, të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të nenit 13, të ligjit nr. 99/2018, “Për buxhetin e vitit 2019”, dhe të shkronjës “b”, të pikës 1, të nenit 7, të ligjit nr.32/2018, “Për Fondin Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës”, me propozimin e ministrit të Shtetit për Diasporën, Këshilli i Ministrave

**V E N D O S I:**

1. Financimin e projektit “Diaspora shkencore si një faktor ndryshimi në procesin e integrimit evropian të Shqipërisë”, me kohëzgjatje 30 (tridhjetë) muaj, me fond total prej 40, 984,477 (dyzet milion e nëntëqind e tetëdhjetë e katër mijë e katërqind e shtatëdhjetë e shtatë) lekësh, sipas dokumentit bashkëlidhur këtij vendimi.



2. Për vitin 2019 për kryerjen e studimit të projektit “Diaspora shkencore si një faktor ndryshimi në procesin e integritit evropian të Shqipërisë”, Fondit Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës i shtohet fondi prej 4,214,895 (Katër milion e dyqind e katërmbëdhjetë mijë e tetëqind e nëntëdhjetë e pesë) lekësh.
3. Fondi i parashikuar në pikën 2 të këtij vendimi përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit për vitin 2019.
4. Fondet për vitet 2020 dhe 2021 për projektin bashkëlidhur këtij vendimi, parashikohen në planin buxhetor afatmesëm të Fondit Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës për vitet 2020-2022.
5. Projekti “Diaspora shkencore si një faktor ndryshimi në procesin e integritit evropian të Shqipërisë” , bashkëlidhur këtij vendimi , do të zbatohet nga Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës.
6. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë , ministri i Shtetit për Diasporën dhe Fondi Shqiptar për zhvillimin e Diasporës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në “Fletoren Zyrtare”.

**KRYEMINISTRI**

**EDI RAMA**

**Në mungesë dhe me porosi**

**ZËVENDËSKRYEMINISRI**

**ERION BRAÇE**

**MINISTRI I SHETITIT  
PËR DIASPORËN**

**PANDELI MAJKO**